

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



TË INVESTOSH SI SHQIPTAR NË HOLLANDË/DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE WEBINAR ME SIPËRMARRËSIT

“Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare” në bashkëpunim me “Unionin e Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë”, organizuan një webinar me temën “Si të bësh biznes si shqiptar në Hollandë”. Qëllimi i këtij trajnimi është të jap konceptet themelore mbi analizën e kostove për zgjerim të biznesit në nivel ndërkombëtar, zgjerimin e vizionit të të bërit biznes dhe përshtatje në tregun ndërkombëtar. Aktiviteti filloi me Hollandën, por do të vazhdojë me disa shtete si Itali, Greqi, Zvicër etj.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



PARASHIKIMI I INSTITUTIT TË VJENËS PËR EKONOMINË

Sipas parashikimeve të reja të lëshuara së fundmi nga Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare rimëkëmbja e ekonomive të Evropës Lindore ku bën pjesë edhe Shqipëria do të jetë e ngadaltë dhe do të varet nga sukcesi në menaxhimin e pandemisë. Në parashikimet e reja Instituti i Vjenës raporton se, ekonomia e Shqipërisë do të shënojë rënie me 6.4 për qind nga -5 për qind që ishin parashikimet e majit 2020, ndërkohe që ka rritur pritshmëritë për ecurinë e ekonomisë në vitin 2021 me 0.8 pikë përqindje. Sipas ekspertëve të Vjenës, ekonomia e vendit do të rritet me 4.6 për qind vitin që vjen.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



ODAT EKONOMIKE KUNDËR MBYLLJES TOTALE: RREZIKOHET HUMBJA E VENDEVE TË PUNËS DHE MBYLLJA E BIZNESEVE

Mbyllja totale nga pandemia COVID-19 po konsiderohet e rrezikshme për humbjen e vendeve të punës dhe falimentimin e bizneseve, duke e dërguar në këtë mënyrë vendin drejt kolapsit. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës z.Berat Rukiqi, ka thënë se nëse vihen në zbatim masat e mbylljes totale rrezikohet stabiliteti financiar i vendit në aspektin buxhetor. Ndërsa, kryetari i Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës z.Arian Zeka, theksoi se karantinimi i Prishtinës do të kthente vendin në një situatë të rënies së aktivitetit ekonomik, duke shtuar se rrezikon një pjesë të madhe të kompanive drejt falimentimit.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME

EKONOMIA POST COVID-19, PROBLEM REMITANCAT DHE EKSPORTET



NIS TRAJNIMI I STRUKTURAVE ADMINISTRATIVE PËR DIASPORËN NË BASHKITË E VENDIT



JURISTJA SHQIPTARE KRIJON PLATFORMËN INFORMUESE RRETH EMIGRIMIT NË AMERIKË



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	103.70	104.40
EUR	123.50	124
CHF	113. ⁶⁰	114.70
GBP	138	138.80
DKK	16. ²⁵	16.65